



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 6181/10 Prot.

Durrës, më 05.03. 2026

VENDIM

Nr. 31, datë 05.03. 2026

PËR

"MIRATIMIN E PERSONELIT AKADEMIK NGA KATEGORIA "PERSONEL AKADEMIK I FTUAR", TË ANGAZHUAR PËR SEMESTRIN E DYTË TË VITIT AKADEMIK 2025-2026, PRANË FAKULTETIT TË SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; neni nr. 62; të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 685, datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës"; Statutit të UAMD-së, neni 47; Rregullores së UAMD-së, neni 64; Vendimit të Senatit Akademik Nr. 12, datë 10.02.2025, "Për miratimin e rregullores për "Personel Akademik të Ftuar", në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës"; si dhe në shkresën Nr. 439/1 Prot., datë 23.02.2026, "Mbi angazhimin e "Personelit Akademik të Ftuar" pranë Fakultetit të Shkencave Politike Juridike për semestrin e dytë, viti akademik 2025-2026" nga Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave, në mbledhjen e datës 05.03.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e personelit akademik nga kategoria "Personel Akademik i Ftuar", të angazhuar për semestrin e dytë, të vitit akademik 2025-2026, pranë Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore FSHPJ
 - Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E KURRIKULAVE, CILËSISË DHE STATISTIKAVE

Nr. 439/1 prot

Durrës, më 23.02 2026

Lënda : Mbi angazhimin e "Personelit Akademik të Ftuar" pranë Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, për semestrin e dytë, viti akademik 2025-2026

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi, Rektor
Universiteti "Aleksandër Moisiu" , Durrës

I nderuar Z.Rektor,

Në mbështetje të Ligjit Nr.80/2015, datë 02.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, bazuar në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 12, datë 10.02.2025, mbi "Miratimin e rregullores për "Personel Akademik të Ftuar" në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës", bazuar në shkresën Nr.439 prot, datë 18.02.2026 nga Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, ju informojmë se:

Personeli akademik i ftuar vendas që do të angazhohet në mësimdhënie pranë këtij fakulteti, për vitin akademik 2025-2026 është:

1. Znj.Ema Lazaj (magjistratë) e cili do të zhvilloj 6 orë leksion në Kursin "E Drejtë Kushtetuese".
2. Z.Kreshnik Buçpapaj (avokat) i cili do të zhvilloj 6 orë leksion në Kursin "E Drejtë e Procedurës Penale"
3. Znj.Olta Hadushaj (magjistratë) e cili do të zhvilloj 6 orë leksion në Kursin "E Drejtë Penale".
4. Z.Aldi Kareco (magjistratë) i cili do të zhvilloj 6 orë leksion në Kursin "E Drejtë Civile".
5. Znj.Enkeledi Hajro (magjistratë) e cili do të zhvilloj 4 orë leksion në Kursin "E Drejtë Penale".
6. Z.Hazbi Lika (Doktor Shkencash) i cili do të zhvilloj 4 orë leksion në Kursin "Antropologji Juridike".
7. Znj.Dhurata Gjoka e cili do të zhvilloj 4 orë leksion në Kursin "Histori e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri".
8. Znj.Mediana Meta e cili do të zhvilloj 4 orë leksion në Kursin "E Drejtë Ndërkombëtare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E KURRIKULAVE, CILËSISË DHE STATISTIKAVE

Penale".

9. Znj.Eralda Met'hasani (Profesor Doktor) e cili do të zhvilloj 6 orë leksion në Kursin "E Drejtë Administrative"

Bazuar në rregulloren e lartpërmendur mbi personelin akademik të ftuar, neni 10, pika 4 ku thuhet se *"Personeli akademik i ftuar vendas ofron aktivitetin didaktik për një apo disa leksione, deri në 6 orë mësimore, brenda vitit akademik"*, lektorët nuk duhet të tejkalojnë 6 orë mësimore në një vit akademik. Përcaktimi i orëve që do të realizohet nga lektorët e ftuar është bërë konformë rregullores së lartpërmendur. Për sa i përket personelit akademik të ftuar Znj.Ema Lazaj dhe Znj.Eralda Met'hasani nga komunikimi elektronik email, konfirmohet nga drejtuesit të njësisë bazë se ngarkesa e tyre do të jetë 6 orë mësimore. Bashkëlidhur do të gjeni edhe emaillet ne lidhje me qartësimin e realizimit të orëve.

Për sa më sipër çdo lektor i rekrutuar si staf akademik me kohë të pjesshme do të realizojë ngarkesën e lëndës sipas ndarjes së propozuar nga drejtuesi i njësisë bazë dhe gjithashtu do ketë mundësinë të angazhohet si staf akademik i ftuar për një leksion të hapur deri në 6-orë mësimore.

Bazuar në shkresën e lartpërmendur nga drejtuesi i Njësisë Kryesore të FSHPJ-së çdo personel akademik i ftuar ka propozimin e Drejtuesit të Njësisë Bazë si dhe Curriculum Vitae për çdo lektor të ftuar.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

**Drejtor i Drejtorisë së Kurrikulës,
Cilësisë dhe Statistikës
Dr. Spiro Paço**